



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4403/2022
Data: 20.06.2022

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2022 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 30.06. 2022 me fillim pune në ora 10:30 në sallën e takimeve. Prezent në takim ishin z.Hisni Luri (Drejtor për Arsim Kulturë Rini dhe Sport), znj.Natyra Kalisi (Drejtoresh për Administratë), Visar Hasallari (Përfaqësues i KVRL-së), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Kimete Kuka –Hasallari (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie, Sociale), Visar Hasallari (Përfaqësues i KVRL-së). Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takimi me përfaqësuesit dhe bashkëpunimi me KVRL-në.
3. Bashkëpunim me zyrën për komunitete dhe kthim.
4. Shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të lehonave dhe nënave vetushqyese.
5. Gjendja e Pandemisë COVID/19.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- para se me proceduar me pikat e rendit të punës nga komuniteti jam informuar se në rast se ka ndodhë ndonjë vdekje në Han të Elezit për me shprehur ngushëllim shkojnë nga dy grupe , një grup shkon me ish kryetarin e komunës , ndërsa grupi tjetër shkon me kryetarin e tanishëm . Mu më doket kjo që është një dukuri negative dhe është mirë ta bisedojmë këtë çështje. Unë jam marr me politik dhe shohë që ekziston një urrejtje e partive në mes vete dhe ky veprim i cili po bëhet tash konsideroj se do ta thellon urrejtjen në mesë të partive dhe punëtorëve të cilët punojnë në administratën komunale. Nuk kam ndonjë qëllim që ta dobësojë dikend por partitë politike kanë ekzistuar gjithmonë dhe do të ekzistojnë , mirëpo partitë duhet të veprojnë jashtë komunës . Nëse e shihni të arsyeshme mund ta votojmë këtë pikë me hyjë në rend të punës.

Zaim Bela thekson:- unë jam kundër që kjo çështje të hynë në rendin e punës për shkak se ajo është çështje private. Ne shkojmë me shprehur ngushëllime pas orës 16:00 dhe është çështje private se me kënd shkojmë dhe nuk besoj që ka ndonjë çështje politike.

Kryesuesi thekson:- këto çështje po ndodhin në orar të punës e nuk po flasë jashtë orarit të punës dhe nuk shkohet në emër të komunës për shkak se mendoj se këto janë pasoja për të rinjët dhe është mirë që të eliminohen.

Resul Suma thekson:- nëse punëtorët shkojnë brenda orarit të punës mund të diskutojmë për këtë çështje por nëse nuk shkojnë brenda orarit të punës nuk mundemi me ju përzierë askujt pas orës 16:00.

Hanumshahe Dibrani thekson:- nëse shkohet brenda orarit të punës duhet të shkojnë në mënyrë kolektive por këtë çështje mund ta diskutojmë te të ndryshmet.

Kryesuesi thekson:- pavarësisht se ndoshta shkojnë pas orës 16:00 nuk duhet të shkohet në emër të komunës për shkak se kjo po bëhet qëllimisht. Disa qytetarë të cilët i kryejnë ritet fetare në Xhaminë e qytetit janë larguar nga Xhamia dhe kanë shkuar në Xhaminë tjetër për shkak se siç kanë potencuar qytetarë se imami po bënë fushatë dhe nuk duhet ta tregoj politikën e Hanit të Elezit.

Natyra Kalisi thekson:- komuna e ka krijuar grupin në vajber dhe çdo herë kur planifikohet me shkuar diku për me shprehur ngushëllime i njoftojmë të gjithë zyrtarët dhe ata të cilët ndahen vetë është problem i tyre. Ata të cilët shprehin gatishmëri me ardhë vijnë, e disa tjerë potencojnë që do të shkojmë më vonë. Komuna i njofton të gjithë dhe asnjë nuk e diskriminon.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim sa i përket rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takimi me përfaqësuesit dhe bashkëpunimi me KVRL-në.

Kryesuesi thekson:- si komitet kemi nevojë me pasur bashkëpunim me të gjitha OJQ-të të cilat janë në Han të Elezit. KVRL-ja në Han të Elezit është duke kryer punë të mira duke e ndihmuar komunitetin dhe është mirë të bashkëpunojmë sepse edhe këto kanë rekomandime të ndryshme por edhe ne për ata në mënyrë që t'i bashkojmë forcat për ta qar Hanin e Elezit përpara e jo me penguar njëri tjetrin. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Visar Hasallari thekson:- KVRL-ja është organizata më e rëndësishme për të rinjët dhe nuk rol në vendimmarrje por shërben si organ këshillues në komunë në departamentin e të rinjve. Me ekzekutivin e ri i cili ka ardhur kemi pasur disa kërkesa dhe kemi gjetur një gjuhë të bashkëpunimit dhe i falënderoj për këtë bashkëpunim drejtorinë e administratës dhe drejtorinë e arsimit për shkak se me këto dy drejtori na bien me bashkëpunuar më shumë. Që nga themelimi i kësaj organizate kemi kërkuar për ndryshimin e rregullore për bursat për studentët dhe në këtë vit ekzekutivi e ka procedura për kuvend dhe është bërë plotësim ndryshimi i rregullores. Ne kemi nevojë për një zyre në mënyrë që me i realizuar aktivitete e tona por besoj se në të ardhmen ekzekutivi do të na i realizon këtë kërkesë.

Kryesuesi thekson:- në emër të komitetit për komunitete do të ju përkrahim që ekzekutivi tu a siguron një zyre që ju me pasur ku me i zhvilluar aktivitete e juaja. Keni pasur protestë për çështjen e nënkalimit të hekurudha dhe a keni ndonjë informacion rreth kësaj çështje.

Visar Hasallari thekson:- protesta është iniciuar nga vet banorët e asaj lagje dhe ne vetëm i kemi mbështetur për shkak se është i domosdoshëm një nënkallim i tillë. Banorët e asaj lagje janë takuar me Kryetarin e Komunës dhe ai i ka mbështetur dhe e dimë që kompetencë komuna nuk ka në atë pjesë por komuna mund ta bënë punën e vetë përmes presioneve të Ministrisë. Si organizatë jemi vetëm për me i ngritur çështjet e nuk jemi për me bërë zgjidhje. Kërkesë kemi parashtruar edhe në Ministrinë përkatëse por nuk kemi gjetur formë të bashkëpunimit, po ashtu i kemi përcjell edhe nënshkrimet e banorëve por nuk kemi hasur në mirëkuptim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

3. Bashkëpunim me zyrën për komunitete dhe kthim.

Kryesuesi thekson:- ftesë i kemi dërguar zyrtarit për bashkëpunim me komunitete dhe kthim por nuk është prezent. Po të ishte prezentë do të kërkonim për numrin e të kthyerve të komunës së Hanit të Elezit qoftë nga bota e jashtme por edhe për personat të cilët kanë marr pjesë në luftërat e huaja. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të lehonave dhe nënave vetushqyese.

Kryesuesi thekson:- e di që komuna i ndihmon me nga 100 €, mirëpo ndoshta ka ndonjë familje që është nëna vetë ushqyese dhe komuna duhet ta ndihmon.

Visar Hasallari thekson:- si organizatë kemi marr pjesë në shumë trajnime në luftimin dhe parandalimin e dhunshëm. Në Han të Elezit janë 11 pjesëmarrës të cilët kanë marr pjesë në luftërat edhe në Siri edhe në Irak, janë katër rekrutues të cilët i kanë nxitur këta për me shkuar në luftëra, janë dy organizatë të cilët janë mbyllur.

Majlinda Kaloshi thekson:- me Ambasadën Britanisë së Madhe kemi mbajtur një trajnim për luftimin e terrorizmit apo bullizmit në përgjithësi. Si komunë përmes organizatave qeveritare ju ka mundësuar njërit prej këtyre personave i cili ka qenë i interesuar për me i marr dhjetë koshere të bletëve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

5. Gjendja e Pandemisë COVID/19.

Kryesuesi thekson:-për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


Kimete Kuka –Hasallari thekson:- gjendja me pandeminë në komunën tonë është e qetë dhe stabile dhe nuk kemi rate por më shqetësues është lija e ujit që është paraqitur dhe fëmijët para fillorë e kanë ndërprerë mësimin por gjendja është nën kontroll.

6. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Komitetit
Mefail Suma

